



BULETINI ELEKTRONIK I SHOQATËS UJËSJELLËS KANALIZIME TË SHQIPËRISË

**SHUKALB**
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

Prill 2022

Çfarë ka të re në SHUKALB!

SHUKALB mbështet Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime Shqiptare në festimin e Ditës Botërore të Ujit 2022



Çdo vit, Dita Botërore e Ujit nxjerr në pah një aspekt specifik të ujit dhe është një mundësi unike për të tërhequr vëmendjen dhe për të krijuar mundësinë për të nxitur qeverinë, shoqërinë civile dhe individët të ndërmarrin veprime.

Tema e zgjedhur nga Kombet e Bashkuara për Ditën Botërore të Ujit të këtij viti ishte “Ujërat nëntokësorë – Të bëjmë të padukshmen të dukshme”, duke tërhequr vëmendjen mbi rëndësinë e mbrojtjes së burimeve tona ujore nëntokësore. Tema është mjaft me vlerë sidomos për një vend si Shqipëria, i cili pjesën më të madhe të furnizimit me ujë të pijshëm e siguron nga burime nëntokësore. [lexo më shumë](#)

Zhvillimi i një dokument projekti për zbatimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë për trajtimin e



Trajnimet dhe programet e ardhshme të zhvillimit të kapaciteteve

[Burimet Ujore dhe Kaptazhet](#)
13 Prill 2022, Tirana

[Tubacionet Kryesore dhe Rezervuarët e Ujit](#)
14 Prill 2022, Tirana

[Shërbimi i Klientit dhe Marrëdhëniet me Publikun](#)
27-28 Prill 2022, Tirana

Konferencat e Ardhshme Ndërkombëtare

[Konferenca virtuale: Konferenca për rikuperimin e ujit të ndotur, ujit të pijshëm dhe burimeve](#)

Online
10-13 Pril 2022

ujërave të ndotura në dy zona rurale në basenin e lumit Drin



Në shkurt 2022, SHUKALB është bërë pjesë e projektit të titulluar “Zhvillimi i një dokument projekti për zbatimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë për trajtimin e ujërave të ndotura në dy zona rurale në basenin e lumit Drin”. Projekti zbatohet në kuadër të Projektit “Promovimi i Menaxhimit të Qëndrueshëm të Burimeve Natyrore në Evropën Juglindore, nëpërmjet përdorimit të qasjes Nexus”, nga Global Water Partnership-Mediterranean (GWP-Med) në partneritet me Komisionin Ekonomik për Evropën të Kombeve të Bashkuara (UNECE), financuar nga Agjencia Austriake e Zhvillimit (ADA). [lexo më shumë](#)

SHUKALB përfundon programin Rotary “Hands Across Waters” me Eventin Vjetor Ndërkombëtar të Diplomimit në Ditën Botërore të Ujit, 22 Mars



Për të dytin vit radhazi, SHUKALB ka bashkuar përpjekjet me Rotary Club të Haifa-s në Izrael, Hi-Teach dhe Rotary Club të Tirana International për organizimin e programit arsimor inovativ STEAM Rotary Hands Across Waters (RHAW) për shkollat e mesme në Shqipëri. Programi RHAW përdor sfidën globale të Ujit dhe Kanalizimeve dhe zgjidhje të reja të avancuara si bazë për edukimin bashkëpunues të shkencës ndërkulturore. Është zhvilluar nga Hi-Teach dhe drejtohet në bashkëpunim me Rotary, i pritur nga Haifa Rotary Club dhe shumë Klube Rotariane, Industri, Qeveri, Akademi dhe OJQ partnere në të gjithë botën.

Si pjesë e programit, shkollat pjesëmarrëse krijojnë binjakëzim dhe vendosin shkëmbime me shkolla të tjera që janë pjesë e

[Konferenca e 9-të e praktikave më të fundit për Menaxhimin Strategjik të Aseteve \(LESAM 2022](#)

Bordeaux, France
11 - 13 Maj 2022

[IFAT 2022 - Panairi tregtar kryesor në botë për ujë, kanalizime, menaxhimin e mbetjeve dhe lëndëve të para](#)

Mynih, Gjermani
30 Maj – 3 Qershor 2022

[Konferenca e 12-të e Micropol dhe Rrezikut Ekologjik](#)

Santiago de Compostela, Spanjë
6 - 10 Qershor 2022

[Humbjet e ujit 2022](#)

Pragë, Republika Çeke
19-22 Qershor, 2022

Bashkohuni me Ne!



programit, në vende të tjera. [lexo më shumë](#)

Trajnime dhe programe të zhvillimit të kapaciteteve

Nxitoni të regjistroheshi në kurset e ardhshme të trajnimit!



SHUKALB ju fton të merrni pjesë në kurset e ardhshme të trajnimit që organizohen përgjatë vitit 2022. Gjeni më shumë detaje në lidhje me regjistrimet për secilin trajnim, në Kalendarin më poshtë.

TRAJNIMET NË PRILL

BURIMET UJORE DHE KAPTAZHET
13 Prill 2022, Tirana

Përzgjedhja e duhur e burimeve ujore si dhe menaxhimi i mirë rezervuarëve janë faktorë kryesor dhe shumë të rëndësishëm për prodhimin e ujit me cilësi të mirë dhe kosto të ulët. Nëse cilësia e ujit është e mirë që në burim apo rezervuar, atëherë dhe kaptazhet do të ofrojnë ujë të pastër dhe në mënyrë efektive për tek impianti i trajtimit apo në rrjetin shpërndarës.



Në këtë kurs trajnimi pjesëmarrësit do të marrin njohuritë bazë mbi burimet ujore dhe karakteristikat e tyre.[lexo më shumë](#)

Regjistrimet në Programin e D-LeaP të Krahassimit të Standartizuar (Benchmarking) për Shoqëritë UK janë tashmë të hapura!

Na tregoni se cfarë mendoni!



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjellës
Kanalizime e Shqipërisë
(SHUKALB), e themeluar në
vitin 2000, është një
Shoqatë profesionale,
jofitimprurëse e
profesionistëve në sektorin e
furnizimit me ujë dhe
kanalizimeve, e cila synon të
përmirësojë menaxhimin e
Sektorit të Furnizimit me Ujë
dhe Kanalizimeve në
Shqipëri, për ta bërë atë më
efiçent, të qëndrueshëm dhe
efektiv në përputhje me ligjet
dhe rregulloret në fuqi në
Shqipëri.



Krahasimi (benchmarking), mbledhja e treguesve të performancës dhe më pas krahasimi i performancës midis shoqërive UK me madhësi dhe kushte të ngjashme, është një mjet kryesor për të përmirësuar performancën e shoqërive UK.

SHUKALB dhe SHUKOS kanë ofruar së bashku Programin D-LeaP Benchmarking për shoqëritë ujësjellës kanalizime si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë që nga viti 2014 në kuadër të Partneritetit të Danubit (D-LeaP), me mbështetjen e Shoqatës Ndërkombëtare të Kompanive Ujësjellës Kanalizime në Zonën e Mbulimit të Lumit Danub (IAWD) [lexo më shumë](#)

SHUKALB nis Programin e tij të Trajnimit për vitin 2022



SHUKALB ka nisur Programin e Trajnimit për vitin 2022 me dhënien e një prej trajnimeve më të kërkuara dhe më të rëndësishme, kursin dy ditor të trajnimit “Pasqyrat financiare dhe roli i tyre në vendimarrje”, mbajtur në Tiranë në datat 2 dhe 3 mars 2022.

Trajnimi u drejtua nga Prof. Asoc. Mirela Miti, Pedagoge, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dhe u ndoq nga drejtues dhe specialistë të departamentit financiar të Shoqërive

Ujësjetellës Kanalizime Malësi e Madhe, Shkodër, Durrës, Peqin dhe Berat-Kuçovë. [lexo më shumë](#)

Të tjera


SHUKALB merr pjesë në takimin fillestar të RCDN-së “Rinisja e programeve të zhvillimit të kapaciteteve për ujërat e ndotura”



Në 15 mars 2022, projekti Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve (RCDN) organizoi online takimin fillestar për rinisjen e zhvillimit të programeve të ZHK për ujërat e ndotura.

Objekti i takimit ishte të siguronte një mirëkuptim të duhur dhe të përbashkët dhe të qartësonte metodologjinë e përgjithshme dhe procesin e vlefshmërisë së programeve të RCDN të ZHK për ujërat e ndotura, si dhe të arrihej dakordësimi për elementët kyç të qasjes zbatuese. [lexo më shumë](#)

SHUKALB merr pjesë në trajnimin RCDN-së mbi Burimet e Financimit të BE-së



Projekti Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve (RCDN) organizoi më 24 shkurt dhe 3 mars 2022 trajnimin online mbi

Burimet e Financimit të BE-së. Objektivi i përgjithshëm i trajnimit ishte forcimi i kapaciteteve të shoqatave partnere të RCDN-së dhe anëtarëve të tyre për të përthithur më mirë fondet e BE-së.

Trajnimi u ndoq nga katërmëdhjetë përfaqësues nga shoqatat partnere të RCDN të pushtetit vendor dhe shoqatat ujësjellës kanalizime. SHUKALB u përfaqësua në trajnim nga Alban Kushi, Menaxher i Shërbimit ndaj Anëtarëve, Ermira Vasili, Administratore Finance dhe Arbana Kola, Menaxhere e Projektit Menaxhimi i Integruar të Aseteve. [lexo më shumë](#)

SHUKALB merr pjesë në trajnimin e RCDN-së mbi Menaxhimin e Ciklit



Gjatë datave 23-25 mars 2022, projekti Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve (RCDN) organizoi takimin mbi menaxhimin e ciklit të trajnimeve të RCDN-së dhe standardet në ofrimin e trajnimeve në Ballkanin Perëndimor. Takimi u organizua në Durrës, Shqipëri.

Qëllimi i këtij takimi ishte përmirësimi i kapaciteteve të shoqatave partnere të RCDN-së për të përmirësuar dhe ofruar trajnim cilësor dhe shkëmbim mes kolegëve, sipas standardeve të cilësisë të përcaktuara nga RCDN. [lexo më shumë](#)

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë,
Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqipëri

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, **Web:** www.shukalb.al

Çregjistrohu